

LIGJ
Nr. 27/2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9831, DATË 12.11.2007, “PËR
DËMSHPËRBLIMIN E ISH-TË DËNUARVE POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

1. Brenda datës 31.12.2017, ish-të dënuarit politikë, të cilët bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore dhe plotësojnë kriteret e neneve 4 e 5, të këtij ligji, drejtpërdrejt apo nëpërmjet kujdestarit ligjor, paraqesin në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën, me shkrim, për përfitimin e dëmshpërblimit financiar për dënimin penal të padrejtë, sipas formularit të paraqitur në aneksin “A”, që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Mosparaqitja e kërkesës brenda afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, sjell humbjen e së drejtës së dëmshpërblimit për ish-të dënuarin politik, i cili bën pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore. Sipas këtij ligji, ish-i dënuari politik i regjimit komunist, që bën pjesë në kategorinë parësore, personi i autorizuar apo kujdestari i tij ligjor nuk mund të rivendosen në afat për paraqitjen e kërkesës pas datës 31.12.2017.”.

Neni 2

Në nenin 23, paragrafi i dytë, data “1.7.2009” zëvendësohet me datën “31.12.2017”.

Neni 3

Dispozita kalimtare

Aplikimet e paraqitura në Ministrinë e Drejtësisë pas datës 1.7.2009, nga subjektet e kategorisë parësore, konsiderohen të vlefshme. Ministria e Drejtësisë fillon procedurën e shqyrtimit administrativ për kërkesat për përfitimin e dëmshpërblimit financiar, të paraqitura nga subjektet e kategorisë parësore, pas datës 1.7.2009.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.3.2017

Shpallur me dekretin nr. 10116, datë 7.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani